



UNHCR
The UN Refugee Agency

Azil në Irlandë:

Udhëzues për të Rinjtë



INFORMACION I RËNDËSISHËM PERSONAL

Emri:

Detajet e kontaktit:

Numri i referencës së kërkesës për azil:

Emri i punonjësit social të Tusla dhe detajet e kontaktit:

.....

Emri i avokatit dhe detajet e kontaktit:

.....

Numri PPS:

Shënimet e mia personale:

.....

.....

.....

.....

Përmbajtja




1. Rreth këtij udhëzuesi 7
2. Çfarë do të thotë të aplikosh për azil? 9
3. Para aplikimit për azil 15
4. Procedura e azilit në Irlandë 19
5. Procesi i ZMN 23
6. Vendimi i ZMN 33
7. Apeli i TAMN 35
8. Informacion tjetër 43
9. Të drejtat tuaja 47
10. Organizata të tjera 51

Ky udhëzues është për fëmijët e pashoqëruar dhe të rinjtë që kërkojnë azil në Irlandë.

Ai shpjegon hapat e ndryshëm në procedurën e azilit.¹ Disa fjalë të caktuara kanë kuptim të veçantë në procedurën e azilit, prandaj le të shohim së pari termin ‘fëmijë të pashoqëruar’. **Fëmijët e pashoqëruar janë fëmijë të cilët nuk janë të shoqëruar nga prindërit e tyre ose ndonjë i rritur tjetër përgjegjës për kujdesin dhe mbrojtjen e tyre, siç është kujdestari.**²

Për një pasqyrë të procedurës së azilit, vizito animimin tonë në www.unhcr.org



1. Deklaratë: Ky udhëzues synon vetëm të japë informacion, dhe nuk jep këshilla ligjore e mund të ndryshojë.
2. Sipas legjislationit irlandez, një fëmijë përcaktohet si person nën moshën 18 vjeç. Termi 'i ri/ e re' në këtë udhëzues nënkupton një adoleshent nën moshën 18 vjeç.

2.

Çfarë do
të thotë të
aplikosh
për azil?

Kur aplikoni për azil në Irlandë, kjo do të thotë që ju kërkoni nga shteti irlandez që t'ju mbajë të sigurt sepse keni frikë të ktheheni në vendin tuaj të origjinës.

'Azil' nganjëherë quhet 'Mbrojtje Ndërkombëtare'. **Procedura e azilit është procesi ku shteti irlandez shikon se pse nuk mund të ktheheni në vendin tuaj dhe pse keni nevojë për azil në Irlandë.**

Në Irlandë ekzistojnë dy forma të mbrojtjes nga dëmi në vendin tuaj të origjinës:

- 1. Statusi i refugjatit**
- 2. Mbrojtja e përkohshme**


Kur të aplikoni për azil, shteti irlandez do të shikojë nëse keni nevojë për statusin e refugjatit ose mbrojtjen e përkohshme. Ata gjithashtu do të shohin nëse ka ndonjë arsye tjetër pse ju duhet të qëndroni në Irlandë. Kjo njihet si leje për të qëndruar. Ligji kryesor për mbrojtjen ndërkombëtare në Irlandë është **Akti i Mbrojtjes Ndërkombëtare 2015**.

Kush konsiderohet refugjat?

Refugjat është dikush që nuk mund të kthehet në shtëpinë e tij ose të saj sepse kanë frikë nga persekutimi për një ose disa nga arsyet e mëposhtme:

- mendimi politik
- besimi
- raca
- kombësia
- pjesëmarrja në një 'grup të veçantë social', e thënë ndryshe një grup personash që kanë diçka të përbashkët, të cilën nuk mund ta ndryshojnë. Për shkak të kësaj karakteristike të përbashkët ata shihen si një grup i veçantë në shoqërinë e tyre dhe mund të jenë në rrezik për pasojë. Shembuj të karakteristikave që mund të krijojnë grupe të caktuara shoqërore përfshijnë gjininë, orientimin seksual dhe/ose nëse një person ka qenë më parë pjesë e një grupi të caktuar, si p.sh. ish-ushtar.

Arsyet mund të bazohen gjithashtu në mendimin politik, fenë, racën, kombësinë ose anëtarësisë e anëtarëve të familjes tuaj në një grup të caktuar shoqëror. Përndjekja është një term ligjor që mund të përfshijë shumë gjëra të tilla si keqtrajtimi, dhuna apo forma të tjera të dëmtimit. Avokati juaj mund t'ju shpjegojë kuptimin e persekutimit.



Çfarë nënkupton mbrojtja e përkohshme?

Njerëzit, të cilëve nuk u jepet statusi i refugjatit mund t'u jepet mbrojtje e përkohshme. **Mbrojtja e përkohshme u jepet njerëzve që janë në rrezik të dëmtimit të rëndë, nëse kthehen në vendin e tyre.**

Disa shembuj të dëmeve të rënda janë:

- dënimi me vdekje
- tortura
- trajtim çnjerëzor ose degradues
- kërcënim serioz për jetën tuaj në rast konflikti të armatosur

Këto terma janë komplekse por **avokati juaj** mund t'ju ndihmojë me shpjegimin e këtyre termave dhe mënyrën se si mund të aplikohen në kërkesën tuaj.

Në disa raste, ju mund të keni frikë nga persekutimi ose dëmtimi i rëndë në vendin tuaj për arsye që kanë ndodhur pas largimit tuaj. Për të fituar azil, ju nuk keni nevojë të keni përjetuar persekutim apo dëmtim të rëndë në vendin tuaj të origjinës. Sidoqoftë, nëse ju ose dikush tjetër i afërt keni përjetuar persekutim ose dëmtim të rëndë në të kaluarën, ju duhet të informoni punonjësën tuaj social dhe avokatin se kjo është shumë e rëndësishme kur shikoni se pse keni nevojë për azil në Irlandë.

Çfarë nënkupton leja për të qëndruar?

Leja e qëndrimit është një leje për imigrim që ju lejon të qëndroni dhe të jetoni në Irlandë edhe nëse nuk keni nevojë për statusin e refugjatit ose mbrojtjen e përkohshme. Ekzistojnë një numër arsyes pse ju mund t'ju jepet leja e qëndrimit, duke përfshirë edhe familjen tuaj ose rrethanat personale. Kur të arrihet një vendim mbi lejen e qëndrimit, Ministri për Drejtësi dhe Barazi do të shqyrtojë:

- sa kohë keni qenë në Irlandë dhe çdo marrëdhënie të rëndësishme që keni këtu
- shkaqe humanitare, duke përfshirë arsye serioze mjekësore
- mënyrën e sjelljes në Irlandë dhe në vende të tjera, përfshirë nëse jeni shpallur fajtorë për ndonjë krim
- çdo arsye tjetër të rëndësishme.

Nëse keni ndonjë informacion që mendoni se mund të ndihmojë aplikimin tuaj për leje qëndrimi, informoju punonjësin tuaj social dhe avokatin.

Për shembull, situata juaj personale mund të ndryshojë gjatë procedurës së azilit, mund të merrni një punë me kohë të pjesshme ose të përfundoni një kurs të mëtejshëm të edukimit, prandaj sigurohuni që punonjësi juaj social dhe avokati të jenë në dijeni për këto ndryshime.

Cilat janë të drejtat e mia gjatë procedurës së azilit?

Ju keni të gjitha të drejtat që kanë të rriturit në procedurën e azilit, por keni edhe disa të drejta shtesë, të cilat përfshijnë:

- **E drejta që interesat tuaj më të mira të merren parasysh:** kjo do të thotë që të gjitha veprimet dhe vendimet që ndikojnë tek ju duhet të bazohen në atë që është më e mira për ju.
- **E drejta për t'u dëgjuar:** kjo do të thotë që kur të rriturit po marrin vendime që ndikojnë tek ju, ju mund të thoni lirshëm se çfarë mendoni se duhet të ndodhë dhe mendimi juaj duhet të merret parasysh.



3.

Para
aplikimit
për azil

Ju jeni një fëmijë i pashoqëruar nëse jeni nën 18 vjeç, jashtë vendit tuaj dhe në Irlandë pa prindin ose kujdestarin tuaj.

Si një fëmijë i pashoqëruar në Irlandë, ju do të dërgoheni tek ekipi i Fëmijëve të Ndarë Azil-kërkues në **Tusla - Agjencia për Fëmijët dhe Familjen**. Ky ekip do të jetë përgjegjës për kujdesin tuaj, ndërsa jeni nën 18 vjeç në Irlandë.



“Më duhej të ikja nga vendi im, për shkak të luftës.

Gjatë udhëtimit të vështirë këtu u ndava nga familja ime. Kur mbërrita në Irlandë isha vetëm.”

Kur të dërgoheni në Tusla, ju do t'u caktohet një **punonjës social**, i/e cili/a do të shikojë nëse aplikimi për azil në Irlandë është në interesin tuaj më të mirë.

“Unë jam një punonjës social. I ndihmoj të rinjtë me të gjitha nevojat e tyre.

Këto nevoja mund të përfshijnë vendin ku do të jetojnë dhe shkojnë në shkollë, dhe nëse është e mundur, madje edhe të krijojnë kontakte me familjen e tyre. Së bashku me çdo të ri/re, unë zhvilloj një plan kujdesi bazuar në nevojat e tij ose të saj dhe atë që është në interesin e tyre më të mirë. Si pjesë e atij plani kujdesi, nganjëherë pranojmë që i riu/ e reja duhet të kërkojë azil. Normalisht ne marrim ndihmë nga një avokat për të arritur atë vendim.”

*Përshëndetje!
Unë jam
Ester*



Nëse punonjësi juaj social vendos që ju duhet të aplikoni për azil, ai ose ajo do të kontaktojë me **Bordin e Ndhmës Ligjore** për të caktuar një avokat për të punuar me rastin tuaj. Ky avokat do t'ju ofrojë këshilla ligjore dhe do t'ju ndihmojë gjatë gjithë procedurës.



Roli i avokatit tuaj: avokati juaj do t'ju ndihmojë me aplikimin për azil. Ai ose ajo do t'ju ndihmojë për të identifikuar arsyen se pse keni nevojë për azil në Irlandë. Është e rëndësishme që t'i flisni atij ose asaj për të gjitha frikërat tuaja. Nëse keni ndonjë problem me avokatin tuaj, ju mund të flisni me punonjësin tuaj social.

E rëndësishme

Gjurmimi i Familjes: ju nuk mund ta dini se ku mund të jetë familja juaj por ju mund të kontaktoni Kryqin e Kuq Irlandez (Njësia e Rikthimit të Lidhjeve Familjare) të cilët mund të jenë në gjendje që t'ju ndihmojnë në gjetjen e familjes tuaj. Ky proces i gjurmimit të familjes mund të ndodhë në çdo fazë të procedurës së azilit ose paraprakisht. Tusla do t'ju ndihmojë me gjetjen e familjes tuaj nëse kjo është në interesin tuaj më të mirë; kjo mund të jetë pjesë e planit tuaj të kujdesit.

Nëse në një farë mënyre kontaktoni me familjen tuaj gjatë procedurës suaj të azilit, ju duhet të informoni punonjësin tuaj social.

4.

Procedura e azilit në Irlandë

Kush merr vendime për aplikimet për azil?

Në Irlandë ka 2 zyra që mund të vendosin nëse keni nevojë për azil:

- **Zyra e Mbrotjes Ndërkombëtare (ZMN):** kjo zyrë do të shqyrtojë aplikimin tuaj për azil. Për të mësuar më shumë, ju lutemi shkoni këtu: www.ipo.gov.ie
- **Tribunali për Apelimet e Mbrojtjes Ndërkombëtare (TAMN):** nëse ZMN vendos që ju nuk keni nevojë për azil, atëherë ju mund ta apelsoni atë vendim tek kjo Tribunale. Për të mësuar më shumë, ju lutemi shkoni këtu: www.protectionappeals.ie



Përmbledhje e procedurës së azilit:

1. APLIKIMI PËR AZIL



Ju së pari do të referoheni tek Tusla. Punonjësi juaj social mund t'ju ndihmojë që të bëni një kërkesë për azil nëse ata mendojnë se kjo është ajo që është më e mira për ju. Ju gjithashtu mund të kërkonti një avokat në këtë moment.

2. INTERVISTA E SHKURTËR



Ju do të bëni një intervistë të shkurtër kur të shkoni në ZMN për të kërkuar azil.

3. PYETËSORI



ZMN do t'ju japë një pyetësor. Pyetësori kërkon informacion rreth jush. Punonjësi juaj social dhe/ose avokati do t'ju japë disa këshilla për këtë.

4. INTERVISTA E GJATË

Kjo është intervista juaj kryesore në ZMN, ku do t'ju bëhen më shumë pyetje në lidhje me kërkesën tuaj për azil. Punonjësi juaj social do të marrë pjesë në këtë intervistë me ju.

5. VENDIMI

Pas intervistës, ZMN vendos nëse keni nevojë për azil. Nëse ZMN vendos se keni nevojë për azil, ju do t'ju lejohet të qëndroni në Irlandë dhe do të keni të drejta të caktuara. Shih faqen 47 në këtë udhëzues për informacion të mëtejshëm mbi këto të drejta.

6. APELI



7. SEANCA DËGJIMORE NË APEL




8. VENDIMI I TAMN

Nëse ZMN vendos që nuk keni nevojë për azil, punonjësi juaj social dhe/ose avokati do të bisedojnë me ju nëse duhet të apeloni vendimin në TAMN.

Nëse paraqitet një apel, punonjësi juaj social dhe avokati do të shkojnë në seancën dëgjimore në TAMN me ju.

Pas dëgjimit, TAMN do të vendosë nëse ZMN ka marrë vendimin e duhur. Nëse TAMN gjen se keni nevojë për azil, do t'ju lejohet të qëndroni në Irlandë dhe do të keni të drejta të caktuara. Shih faqen 47 në këtë udhëzues për informacion të mëtejshëm mbi këto të drejta. Nëse TAMN pajtohet me ZMN dhe gjen se nuk keni nevojë për azil, punonjësi juaj social dhe/ose avokati do të bisedojnë me ju për çfarë duhet bërë më pas.



5.

Procesi i
ZMN

Le t'i hedhim një sy nga afër secilit hap të procedurës:

INTERVISTA E SHKURTËR

Punonjësi juaj social do të shkojë me ju në zyrën e ZMN në Dublin, ku mund të aplikoni për azil. Një zyrtar i ZMN do të mbajë një intervistë të shkurtër me ju dhe punonjësин tuaj social. **Në këtë intervistë do t'ju parashtrohen pyetje në lidhje me identitetin tuaj, identitetin e prindërve tuaj, vendin tuaj, rrugën që keni ndjekur për në Irlandë dhe arsyet pse po aplikoni për azil.** Nëse jeni mbi 14 vjeç, fotografia dhe shenjat e gishtave tuaja do të merren në mënyrë që ZMN të mund të krijojë identitetin tuaj dhe të shoh nëse keni aplikuar për azil në një vend tjetër të Bashkimit Evropian. Ju gjithashtu do të merrni një kartelë nga ZMN dhe numrin e referencës për aplikimin tuaj që ju duhet të mbani me vete në çdo kohë.

PYETËSORI

ZMN do t'ju kërkojë të plotësoni një pyetësor dhe ta dërgoni atë në zyrën e ZMN. Punonjësi juaj social do t'ju drejtojë **pyetje më të detajuara rreth jush dhe aplikimit tuaj për azil.** Punonjësi juaj social dhe avokati do t'ju japin disa këshilla se si të plotësoni pyetësorin. Pyetësori i plotësuar ndihmon zyrtarin e ZMN për të kuptuar arsyet pse keni frikë të ktheheni në vendin tuaj të origjinës. Gjithashtu, ai i ndihmon ata të përgatiten për intervistën tuaj të gjatë.



INTERVISTA E GJATË

ZMN do t'i dërgojë punonjësit tuaj social një letër me datën e takimit për intervistën e gjatë. Intervista juaj e gjatë është kryesorja për të shqyrtuar nëse keni nevojë për azil në Irlandë. Nganjëherë ajo quhet **intervista personale ose kryesore**. Avokati juaj dhe punonjësi social do t'ju ndihmojnë të përgatiteni për këtë intervistë. Zyrta i ZMN që merret me aplikimin tuaj do të ketë lexuar të gjitha letrat tuaja, përfshirë pyetësonin tuaj. Ai ose ajo do të kenë bërë kërkime gjithashtu për vendin tuaj të origjinës para intervistës; ky informacion quhet **informacion për vendin e origjinës** ose IVO.

A keni nevojë apo dëshironi të keni një përkthyes për intervistën tuaj?

Mos harroni t'i tregoni punonjësit tuaj social dhe/ose avokatit para ditës së intervistës.

Do të ishit më rehat nëse intervistoheni nga një zyrtar mashkull ose zyrtare femër e ZMN?

Ju gjithashtu mund të dëshironi të keni një përkthyes mashkull apo femër të pranishëm për intervistë. Mos harroni t'i tregoni punonjësit tuaj social dhe/ose avokatit para ditës së intervistës. ZMN më pas do të përpiket të sigurojë që përkthyesi dhe intervistuesi të jetë një burrë apo një grua, në varësi të asaj që keni kërkuar.

“Më duhet një përkthyes pasi nuk flas anglisht aq mirë.

Ka edhe disa pjesë të historisë sime, për të cilën e kam të vështirë të flas, mendoj se do t'i kërkoj Esterit nëse mund të kem intervistuese dhe përkthyes femër. Kështu do të ndihesha më rehat në intervistë.”




Kjo intervistë zakonisht zgjat rreth 2 ose 3 orë, por ju do të lejoheni të bëni pushime të rregullta gjatë kësaj kohe. **Nëse keni nevojë për një pushim, mund t'i thoni zyrtarit të ZMN dhe ai ose ajo do t'ju japë kohën që ju nevojitet.** Është e rëndësishme të jeni të sqartë dhe të vërtetë gjatë kësaj interviste, dhe të jepni sa më shumë hollësi që mund të mbani mend. Zyrtari i ZMN dëshiron të dëgjojë historinë tuaj dhe do të bëjë pyetje për t'ju ndihmuar që ta tregoni atë. Kjo është mundësia juaj kryesore që t'i tregoni atij ose asaj të gjitha arsyet pse keni nevojë për azil në Irlandë. **Mos kini frikë t'i tregoni**

zyrtarit/es së ZMN për ndonjë përvojë të keqe që mund të keni pasur në vendin tuaj të origjinës. Ajo çfarë do të thoni në intervistë **nuk do t'i komunikohet** askujt në vendin tuaj të origjinës.

Nëse nuk kuptoni ndonjë nga pyetjet që ju drejton zyrtari i ZMN, shpreheni dhe kërkoni nga ai ose ajo që të përsërisë ose riformulojë pyetjen. Zyrtari i ZMN do të mbajë një raport me shkrim për intervistën. Ai ose ajo do ta ndërpresë intervistën herë pas here dhe do ta lexojë raportin për ju. Zyrtari do t'ju kërkojë të konfirmoni nëse është i saktë.

E rëndësishme



Kur të lexohet raporti i shkruar, është e rëndësishme që ta dëgjoni me shumë kujdes. A është regjistruar çdo gjë pikërisht ashtu siç ju e thatë? A është i saktë i gjithë informacioni në raportin e shkruar? A ka ndonjë informacion të rëndësishëm që është lënë jashtë? Tregojni zyrtarit të ZMN nëse është i saktë apo jo. Ai ose ajo do të korrigjojë gabimet dhe lapsuset në raportin e shkruar. Ju gjithashtu mund të mbani mend diçka në këtë pikë që keni harruar të thoni më parë. Tani është koha për t'i dhënë atë informacion zyrtarit të ZMN, pasi ai mund të jetë me të vërtetë i dobishëm kur ai ose ajo të vendosë për kërkesën tuaj për azil. Kur të jeni të kënaqur se raporti është i saktë, mund ta nënshkruani atë. Nënshkrimi juaj nënkupton që çdo gjë e shkruar në këtë faqe është e saktë dhe e vërtetë.

Ja se si do të duket salla e intervistës në ZMN.

Gjatë intervistës tuaj, çdo person ka një rol të ndryshëm dhe të gjithë ulen në një vend të caktuar. Le t'i shohim më nga afër rolet e ndryshme që njerëzit kanë në dhomën e intervistës.


PUNONJËSI SOCIAL



PËRKTHYESI

ZYRTARI I ZMN





Zyrtari i ZMN është përgjegjës për intervistën. Ai ose ajo do t'ju bëjë pyetje rreth aplikimit tuaj për azil dhe do të dëgjojë me kujdes çdo gjë që ju thoni. Ai ose ajo do të regjistrojë këtë informacion në kompjuter ose me shkrim. Kjo njihet si **regjistrimi i intervistës**.



Punonjësi juaj social do të shkojë në intervistë me ju. Ai ose ajo është atje si një mbështetje për ju, por pritet që ju t'i përgjigjeni pyetjeve me fjalët tuaja. Në fund të intervistës, zyrtari i ZMN mund t'i kërkojë punonjësit tuaj social nëse ai ose ajo ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar para mbylljes së takimit. Avokati juaj mund të shkojë në intervistë nëse ai apo ajo e ndjen se është e nevojshme.





PËRKTHYESI

Ju gjithashtu mund të keni një përkthyes që t'ju ndihmojë gjatë intervistës. Përkthyesi do t'ju ndihmojë ju, nëpunësin e ZMN dhe personat e tjerë në sallën e intervistës për të biseduar me njëri-tjetrin. Përkthyesit flasin anglisht dhe gjuhën që ju flisni. Përkthyesi do të përkthejë pyetjet e zyrtarit të ZMN në gjuhën tuaj dhe atë që ju thoni do ta

përkthejë në anglisht. Ai ose ajo luan një rol kyç për t'ju ndihmuar të komunikoni, prandaj është e rëndësishme që të kontrolloni në fillim nëse e kuptoni njëri-tjetrin.

Mos harroni se përkthyesve nuk u lejohej të japin mendimin e tyre ose të ndryshojnë atë që thoni. Përkthyesi është aty vetëm për t'ju ndihmuar me komunikimin dhe ai ose ajo nuk ka rol në vendim-marrje.

Përkthyesve nuk u lejohej që t'u tregojnë njerëzve të tjerë për ju. Ai ose ajo duhet të mbajë intervistën konfidenciale kështu që mos u bëni merak për të thënë para tyre se përse keni frikë që të ktheheni në vendin tuaj të origjinës.

E rëndësishme

Nëse nuk e kuptoni shumë mirë përkthyesin, duhet të njoftoni menjëherë zyrtarin e ZMN ose punonjësin tuaj social. Kjo **nuk** do të ketë një ndikim negativ në aplikimin tuaj për azil dhe mund të nënkuptojë thjesht që intervista e ZMN shtyhet për një ditë tjetër me një përkthyes tjetër që ju e kuptoni.



Pas intervistës suaj, zyrtari i ZMN do të shqyrtojë mëtej kërkesën tuaj për azil. Për ta bërë këtë, ai ose ajo do të marrë parasysh sa më poshtë:

- **informacionin që keni dhënë për atë që ju ka ndodhur ose të tjerëve afër jush në të kaluarën**
- **gjendjen e përgjithshme në vendin tuaj, duke përfshirë atë që thotë vendi i informacionit të origjinës**
- **mundësinë që ju mund të jeni në rrezik dëmtimi ose persekutimi nëse ktheheni në vendin tuaj të origjinës**

Nganjëherë, njerëzit thërriten sërish në zyrën e ZMN për një intervistë të dytë nëse nevojiten të sqarohen disa informacione ose nëse zyrtari i ZMN ka ndonjë pyetje tjetër.



Ju mund të lexoni për procedurën e azilit për fëmijët e pashoqëruar dhe të rinjtë në [Broshurën me Informacion për Fëmijët e Ndarë/Të Miturit e Pashoqëruar të Zyrës për Mbrojtje Ndërkombëtare, të cilët janë Kërkues për Mbrojtje Ndërkombëtare.](#)

“Pak javë pas intervistës sime të gjatë me zyrtarin e ZMN, ata më kontakuan përsëri për të pasur një intervistë të mëtejshme.

Unë u shqetësova, por Esteri, punonjësja ime sociale, më siguroi se mbajtja e një interviste tjetër nuk ishte problem. Zyrtarja e ZMN ishte shumë miqësore dhe thjesht donte të kontrollonte përsëri disa nga informacionet në lidhje me kërkesën time.”



6.

Vendimi i

ZMN

Pak kohë pas intervistës tuaj, punonjësi juaj social do të marrë një vendim nga ZMN.

Ky vendim është një rekomandim dhe nëse ju jepet statusi i refugjatit ose mbrojtja e përkohshme, ju do të merrni një letër tjetër zyrtare nga Ministri për Drejtësi dhe Barazi, e cila njihet si deklaratë. Ju lutemi të jeni të duruar, pasi ndonjëherë mund të zgjasë pak kohë para se të merrni një vendim përfundimtar mbi kërkesën tuaj për azil.

Ka një sërë vendimesh të ndryshme që mund të merrni:

- **Dhënia (vendim pozitiv) e statusit të refugjatit.**
- **Dhënia e mbrojtjes së përkohshme. Nëse ju jepet mbrojtje e përkohshme, ju mund të apeloni përsëri vendimin e mosdhënies së statusit të refugjatit.**
- **Nëse ju është refuzuar statusi i refugjatit ose mbrojtja e përkohshme, Ministri për Drejtësi dhe Barazi do të vendosë nëse do t'ju japë apo jo lejen e qëndrimit. Nëse ju jepet leja e qëndrimit, ju ende mund të apeloni vendimin për mosdhënien e statusit të refugjatit ose mbrojtjes së përkohshme.**

Avokati juaj dhe punonjësi social do të bisedojnë me ju në lidhje me opsionet tuaja pas marrjes së vendimit nga ZMN.

7.


Apeli i
TAMN

Nëse nuk ju jepet statusi i refugjatit ose mbrojtja e përkohshme nga ZMN, ju mund të apelonit këto vendime në TAMN.

Nëse ju jepet mbrojtje e përkohshme nga ZMN, por ju mendoni se ju duhet të kishit marrë statusin e refugjatit, ju mund të apelonit këtë vendim. Avokati juaj dhe punonjësi social do të bisedojnë me ju në lidhje me këto opsione nëse ato zbatohen në rastin tuaj.

Çfarë do të thotë të apelojsh vendimin e ZMN? **Kjo do të thotë që ju besoni se vendimi i ZMN ishte i gabuar dhe se keni nevojë për azil në Irlandë.** Një gjykatë e pavarur, TAMN, do të shqyrtojë më pas vendimin për të parë nëse vendimi ishte i saktë apo jo.

Kur avokati dorëzon apelin kundër vendimit të ZMN, ju do t'ju jepet një datë për **seancën dëgjimore në TAMN**. Këtu, ju, punonjësi juaj social, avokati juaj dhe zyrtari i ZMN do të mbajnë një takim me një anëtar të Tribunalit nga TAMN. Avokati juaj do të shpjegojë pse ai apo ajo mendon se ZMN ka marrë vendim të gabuar. Anëtari i Tribunalit mund t'ju bëjë disa pyetje gjatë seancës dëgjimore.



“Gjatë seancës së apelit, anëtari i Tribunalit më bëri pyetje të ngjashme me pyetjet e zyrtarit të ZMN. Punonjësi im social dhe avokati më përgatiten mirë për seancën dëgjimore, kështu që e dija se çfarë të prisja. Në fillim të procedurës, anëtari i Tribunalit e shpjegoi procesin në një mënyrë që të ishte e lehtë për t'u kuptuar”.

Ja se si do të duket dhoma e seancës në TAMN.

Gjatë apelit, çdo person ka një rol të ndryshëm dhe të gjithë ulen në një vend të caktuar. Le të shohim nga afër rolet e ndryshme që njerëzit kanë në sallën e dëgjimit.



ANËTARI I
TAMN

ZYRTARI
PËRFAQËSUES I ZMN





Anëtari i Tribunalit është përgjegjës për seancën dëgjimore. Ai ose ajo do t'ju bëjë pyetje rreth aplikimit tuaj për azil dhe do të dëgjojë me kujdes çdo gjë që ju thoni. Ai ose ajo mund të mbajë disa shënime gjatë dëgjimit.



Ju mund të keni një përkthyes që t'ju ndihmojë gjatë apelit. Përkthyesi do t'ju ndihmojë ju, anëtarin e Tribunalit dhe personat e tjerë në sallën e dëgjimit për të biseduar me njëri-tjetrin. Ashtu si në ZMN, roli i përkthyesit është të përkthejë çdo gjë që thuhet nga ju, anëtari i Tribunalit dhe personat e tjerë në sallën e dëgjimit. Duhet të siguroheni që e kuptoni përkthyesin. Nëse nuk e kuptoni përkthyesin, duhet t'i thoni menjëherë Anëtarit të Tribunalit dhe/ose punonjësit tuaj social. Mos harroni se kjo **nuk** do të ketë një ndikim negativ në aplikimin tuaj për azil dhe mund të nënkuptojë thjesht që intervista e TAMN shtyhet për një ditë tjetër me një përkthyes tjetër që ju e kuptoni.



Punonjësi juaj social dhe avokati do të shkojnë në seancën dëgjimore të apelit me ju. Ata janë atje si një mbështetje për ju, por do t'ju kërkohet që t'u përgjigjeni pyetjeve me fjalët tuaja. Ndonjëherë, anëtari i Tribunalit do t'i kërkojë avokatit dhe punonjësit tuaj social që të flasin për ju në disa çështje që lidhen me kërkesën tuaj për azil. Avokati juaj do të japë argumente ligjore përse keni nevojë për azil.



Një zyrtar nga ZMN gjithashtu do të jetë në seancë. Në seancën TAMN, Anëtari i Tribunalit mund t'i drejtojë këtij zyrtari pyetje në lidhje me vendimin e ZMN.

DËSHMITARI

Ndonjëherë, dëshmitarët mund të marrin pjesë në seancën e TAMN. Dëshmitari i thotë Anëtarit të Tribunalit informacionin përkatës për kërkesën tuaj për azil, sikur ai ose ajo ka parë diçka që ju ka ndodhur ju dhe/ose familjes tuaj në të kaluarën. Avokati juaj do të bisedojë me ju në lidhje me këtë nëse zbatohet për kërkesën tuaj për azil.

Nëse Anëtari i Tribunalit mendon se ZMN ka marrë vendim të gabuar, ata do të marrin një vendim të ri. Pastaj Ministri për Drejtësi dhe Barazi do t'ju lëshojë një deklaratë për statusin e refugjatit ose mbrojtjen e përkohshme, në varësi të asaj që vendos Anëtari i Tribunalit.



TAMN ka udhëzime të veçanta për dëgjimin e apelineve nga fëmijët dhe të rinjtë. Për më shumë informacion, shih Udhëzues i Tribunalit të Apelineve për Mbrojtje Ndërkombëtare. Nr. 2017/5 Apeline nga Kërkuesit Fëmijë.



Nëse apeli juaj në TAMN nuk ishte i suksesshëm dhe ju nuk keni marrë mbrojtje të përkohshme apo leje qëndrimi nga ZMN, ju do të keni **5 ditë afat** për të paraqitur informacion të ri tek Ministri për Drejtësi dhe Barazi.

Ky informacion do të shpjegojë pse duhet t'ju jepet leja e qëndrimit. Është e rëndësishme që ju, punonjësi social dhe/ose avokati juaj ta paraqesin informacionin sa më shpejt të jetë e mundur. Ministri për Drejtësi dhe Barazi do të shqyrtojë vendimin origjinal për mosdhënien e lejes së qëndrimit. Nëse ju refuzohet leja e qëndrimit, avokati juaj dhe punonjësi social do të diskutojnë të gjitha opsionet që janë në dispozicion për ju, duke përfshirë ribashkimin me familjen tuaj në vendin tuaj, nëse kjo është në interesin tuaj më të mirë.



8.

Informacion
tjetër

Çfarë është procedura e vlerësimit të moshës?

Ndonjëherë, nëse zyrtari i ZMN ose punonjësi social i Tusla ka dyshime në lidhje me moshën tuaj, ata mund të caktojnë të kryejnë një vlerësim të moshës. Kjo mund të përfshijë një intervistë të veçantë me ZMN dhe/ose Tusla. Nëse keni ndonjë dokument identiteti, certifikatë lindje ose informacione të tjera që tregojnë moshën tuaj, atëherë ndajeni atë me punonjësin tuaj social dhe me oficerin e ZMN. Nëse ZMN vendos që jeni mbi moshën 18 vjeç në funksion të aplikimit tuaj për azil, atëherë ju do të trajtoheni në procedurën e azilit si i rritur. Kjo gjithashtu mund të nënkuptojë që ju duhet të largoheni nga strehimi juaj aktual dhe të zhvendoseni në një lloj tjetër strehimi të njohur si qendër strehimi e drejtpërdrejtë.

Çfarë është Rregullorja e Dublinit e BE-së?

Rregullorja e Dublinit e Bashkimit European (BE) është një marrëveshje midis vendeve në BE. Ajo përcakton rregullat që duhen ndjekur për të vendosur se cili vend në BE duhet të shqyrtojë kërkesën tuaj për azil. Ajo quhet Rregullorja e Dublinit sepse marrëveshja u nënshkrua në Dublin.

A jeton nëna, babai, motra, vëllai, halla jote apo xhaxhai juaj në një vend tjetër në BE? A doni të bashkoheni me ta? Ju lutemi njoftoni avokatin dhe punonjësin social për anëtarët e familjes në vendet e tjera të BE sa më shpejt që të jetë e mundur. ZMN pastaj mund të kërkojë nga shteti tjetër i BE që të shqyrtojë kërkesën tuaj për azil, që të mund të shkoni dhe të bashkoheni me familjen tuaj atje.

Avokati juaj do të jetë në gjendje t'ju japë më shumë informacion nëse Rregullorja e Dublinit zbatohet në rastin tuaj.

Çfarë është Prioriteti?

Ju mund ta keni dëgjuar punonjës in tuaj social ose avokatin duke folur për prioritetin e aplikimit tuaj. Kjo do të thotë se, nëse aplikimi juaj bën pjesë në kategori të caktuara, atëherë ai mund të “prioritizohet” (ose ka përparësi) dhe intervista juaj do të organizohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Arsyet për prioritetin e aplikimeve përfshijnë: nëse jeni një fëmijë i pashoqëruar, nëse keni probleme të rënda shëndetësore ose nëse vini nga një prej këtyre vendeve: Siria, Eritrea, Iraku, Afganistani, Irani, Libia ose Somalia.

A mund të punoj ndërkohë që aplikimi im për azil po shqyrtohet?

Nëse nuk keni marrë një vendim nga ZMN brenda 9 muajve nga paraqitja e kërkesës suaj për azil, ju mund të merrni leje për të punuar në mënyrë të ngjashme me të rinjtë irlandezë. Ka rregulla të caktuara për punësimin e të rinjve në Irlandë, për shembull, fëmijët nën moshën 16 vjeç nuk mund të punësohen në punë të rregullta me kohë të plotë, por mund të bëjnë punë gjatë pushimeve verore. Punonjësi juaj social do t’ju japë informacion të mëtejshëm mbi të drejtën tuaj për punë.



Ju mund të lexoni më shumë rreth Rregullores së Dublinit të BE-së në ZMN, Fëmijët që kërkojnë Mbrojtje Ndërkombëtare, Broshura për Fëmijët në Procedurën e Dublinit.

Ju mund të lexoni më shumë rreth politikës së ZMN-së rreth prioritetit në Prioriteti i Aplikimeve për Mbrojtje Ndërkombëtare Sipas Aktit të Mbrojtjes Ndërkombëtare 2015.



9.

Të drejtat
tuaja

Të drejtat tuaja nëse ju jepet statusi i refugjatit ose mbrojtja e përkohshme

Nëse ju jepet statusi i refugjatit ose mbrojtja e përkohshme ju keni të drejta të caktuara që përfshijnë:

- Leje për të jetuar në Irlandë për të paktën 3 vjet.
- Ju do të lejoheni të punoni si të rinjtë irlandezë, nëse dëshironi.
- Ju mund të ndiqni të njëjtin arsim fillor dhe të mesëm si dhe të rinjtë irlandezë dhe mund të kualifikoheni për të drejtën për pagesë falas për të ndjekur arsimin e nivelit të tretë pas tri vitesh qëndrimi.
- Ju mund të merrni të njëjtat ndihma mjekësore dhe ndihma sociale si të rinjtë irlandezë.
- Ju mund të udhëtoni jashtë vendit ashtu si qytetarët irlandezë, por ju mund të keni nevojë për vizë për të shkuar në një vend tjetër dhe/ose duhet të aplikoni për një dokument udhëtimi (si p.sh. pasaportë). Ka rregulla të ndryshme për të aplikuar për një dokument udhëtimi nëse keni status refugjati ose mbrojtje të përkohshme, kështu që flisni me punonjësin tuaj social.
- Ju mund të aplikoni tek Ministri për Drejtësi dhe Barazi për leje që anëtarët tuaj të afërt të familjes të vijnë në Irlandë dhe të jetojnë me ju; kjo quhet ribashkim familjar. Kërkesa për ribashkim familjar duhet të bëhet brenda 12 muajve nga marrja e statusit të refugjatit ose mbrojtjes së përkohshme.
- Ju mund të aplikoni për t'u bërë shtetas irlandez pas 3 vjetësh nëse keni statusin e refugjatit. Nëse ju është dhënë mbrojtje e përkohshme, ju mund të aplikoni për t'u bërë shtetas irlandez pas 5 vjetësh.

Cilët anëtarë të familjes mund të aplikojnë si pjesë e një aplikimi për ribashkim familjar?

Kur ju jepet statusi i refugjatit ose mbrojtja e përkohshme, dhe për sa kohë që jeni pa shoqërim dhe nën moshën 18 vjeç, ju mund të aplikoni për anëtarët vijues të familjes për të ardhur dhe për të jetuar me ju në Irlandë.

- **Prindërit tuaj**
- **Vëllai dhe motrat, nëse ata janë nën 18 vjeç dhe të pamartuar**

Sipas Aktit për Mbrojtje Ndërkombëtare, Ministri për Drejtësi dhe Barazi mund të refuzojë këto kërkesa vetëm në rrethana të kufizuara. Më në përgjithësi, mund të jesh akoma në gjendje të bësh një kërkesë për ribashkim familjar nëse ke mbushur 18 vjeç ose të kërkesë për të afërmit e tjerë që të bashkohen me ty, por kjo do të varet nga rrethanat tuaja. Punonjësi juaj social do të flasë me ju për këtë dhe do t'ju ndihmojë që të aplikoni për bashkim familjar.


E rëndësishme



Ju duhet të aplikoni për bashkim familjar sipas Aktit të Mbrojtjes Ndërkombëtare **brenda 12 muajve** nga dhënia e statusit të refugjatit ose e mbrojtjes së përkohshme. Mos harroni të pyesni punonjësin tuaj social për ndihmë në përgatitjen e një aplikimi për bashkim familjar.

Të drejtat tuaja nëse ju jepet leja e qëndrimit

Leja e qëndrimit nënkupton që ju mund të qëndroni në Irlandë për një periudhë kohe sipas kushteve të caktuara. Kjo leje ka gjasa të zgjatet në fund të asaj periudhe nëse Ministri për Drejtësi dhe Barazi është i kënaqur që kushtet nuk janë shkelur. Ju mund të aplikoni për t'u bërë qytetar irlandez pasi të keni jetuar në Irlandë për 5 vjet.



“Isha kaq i lumtur kur më dhanë statusin e refugjatit. Tani mund të planifikoj të ardhmen time në Irlandë.”

Ju mund të gjeni më shumë informacion për të drejtat tuaja në **Zyrën e Informacionit për Qytetarët.**

10.

Detajet e
organizatave
që mund të
kontaktoni
për ndihmë

Ekipi për Fëmijët e Ndarë Azil-kërkues, Tusla - Agjencia për Fëmijët dhe Familjen

mund të kontaktohet në Spitalin e Sir Patrick Dun, Lower Grand Canal Street, Dublin 2 D02 P667 ose duke telefonuar në numrin 01 647 7000. Për më shumë informacion, vizito:

www.tusla.ie/services/alternative-care/separated-children/

Bordi i Ndhmës Ligjore (BNL), Njësia e Fëmijëve të Ndarë (Shërbimi Ligjor për Refugjatët)

ofron këshilla ligjore për azil-kërkuesit, duke përfshirë të rinjtë në procedurën e azilit. Zyrat e tyre kryesore ndodhet në 48-49 North Brunswick Street, Georges Lane, Smithfield, Dublin 7, D07 PE0C. Ju mund t'i kontaktoni ata duke i telefonuar në numrin **1800 23 83 43** ose duke dërguar një email në adresën **smithfieldlawcentre@legalaidboard.ie**. Ju mund të lexoni më shumë rreth BNL-së dhe mënyrës se si të aplikoni për ndihmë në: **www.legalaidboard.ie**

Avokati i Popullit për Fëmijët

është një zyrë që shqyrton ankesat e bëra nga fëmijët dhe të rinjtë në lidhje me veprimet e organizatave publike. Zyrat e tij janë në Millennium House, 52-56 Great Strand Street, Dublin 1. Ju mund t'i kontaktoni duke telefonuar në numrat: **1800 202040** ose **01 865 6800** ose duke u dërguar një email në adresën: **oco@oco.ie**. Për më shumë informacion, vizito: **www.oco.ie**

Shërbimi i Kryqit të Kuq Irlandez për Rikthimin e Lidhjeve Familjare

mund të jetë në gjendje t'ju ndihmojë nëse keni një anëtar familjeje të humbur jashtë Irlandës. Ju mund t'i kontaktoni duke telefonuar në numrin: **01 642 4600** ose duke dërguar email në adresën: **restoringfamilylinks@redcross.ie**. Për më shumë informacion, vizito: **www.redcross.ie/programmes-and-services-in-ireland/find-missing-family/**

Aleanca për të Drejtat e Fëmijëve

ka një linjë telefonike për fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre ose njerëzit që punojnë me ta për të pasur qasje në informacion ligjor. Ju mund t'i kontaktoni duke telefonuar në numrin: **01 9020494** ose duke na dërguar email në adresën: **query@childrensrights.ie**. Gjithashtu, është e mundur që të rezervoni një takim për klinikat e tyre të ofrimit të këshillave ligjore. Për më shumë informacion, vizito:

www.childrensrights.ie/content/childrens-access-justice

Shoqëria Irlandeze për Parandalimin e Mizorisë ndaj Fëmijëve (ShIPMF)

është një organizatë kombëtare bamirësie për mbrojtjen e fëmijëve. Zyrat e tyre janë në 29 Lower Baggot Street, Dublin 2. Ata drejtojnë një shërbim kombëtar 24 orë të dëgjimit për fëmijët, të quajtur ChildLine. Është privat, konfidencial dhe jo-gjykues. Ata mund të kontaktohen pa pagesë nga kudo në Irlandë në numrin **1800 66 66 66**. Ju mund të vizitoni edhe faqen e tyre të internetit: **www.ispcc.ie**

Barnardos

është organizatë bamirësie për fëmijë që organizon fushata për të drejtat e fëmijëve dhe familjeve. Zyrat e tyre janë në Christchurch Square, Dublin 8. Ju mund t'i kontaktoni duke telefonuar në numrat: **1850 222 300** ose **01 453 0355** ose duke na dërguar një email në adresën: **info@barnardos.ie**. Ju mund të vizitoni edhe faqen e tyre të internetit: **www.barnardos.ie**

Fuqizimi i Njerëzve nën Kujdes (FNK)

avokatët për të drejtat e të rinjve nën kujdes dhe gjithashtu punon me të rinjtë që përgatiten për tu larguar nga kujdesi dhe periudha pas kujdesit. Ju mund të kontaktoni zyrën e FNK Dublin duke telefonuar në numrin: **01 872 7661**. Zyrat e tyre janë në 7 Red Cow Lane, Smithfield, Dublin 7. Për më shumë informacion, vizito: **www.epiconline.ie**

SPUNOUT.ie

është faqja e internetit për të rinjtë e Irlandës, e krijuar nga të rinjtë, për të rinjtë. Faqja e internetit ofron informacion mbi një gamë temash të ndryshme, duke përfshirë arsimin, punësimin dhe shëndetin. Për më shumë informacion, vizito: **www.spunout.ie**

Shërbimi Rinor 'BeLonG To'

është organizata kombëtare që mbështet të rinjtë lezbike, homoseksualë, biseksualë, transeksualë dhe interseks (LGBTI+) në Irlandë. Ata sigurojnë informacion dhe mbështetje jo-gjyquese dhe konfidenciale. Ata gjithashtu drejtojnë grupe rinore. Zyrat e tyre janë në Parliament House, 13 Parliament Street, Dublin 2, D02 P658. Ju mund t'i kontaktoni duke telefonuar në numrin: **01 670 6223** ose duke dërguar email në adresën: **info@belongto.org**. Ju mund të lexoni më shumë informacion për BeLonG To në: **www.belongto.org**

Këshilli Irlandez për Refugjatët

ka një Qendër Juridike të Pavarur dhe Shërbimin e Zakonshëm, i cili mund të jetë në gjendje t'i përgjigjet pyetjeve individuale dhe të japë informacion. Ata gjithashtu punojnë me të rinjtë në procedurën e azilit. Zyrat e tyre janë në 37 Killarney Street, Mountjoy, Dublin 1 dhe mund të kontaktohen duke telefonuar në numrin **01 764 5854**. Faqja e internetit e Këshillit Irlandez për Refugjatë është: **www.irishrefugeecouncil.ie**

NASC Ireland

ka një shërbim falas në dispozicion që ofron këshilla dhe informacion ligjor për një sërë çështjesh që lidhen me emigracionin dhe azilin. Zyrat e tyre janë në 34 Paul Street, Cork, T12 W14H dhe mund të kontaktohen duke telefonuar në numrin **021 427 3594**. Për më shumë informacion, shih: **www.nascireland.org**

Doras Luimni

jep këshilla dhe informacione ligjore mbi një sërë çështjesh të emigracionit. Zyrat e tyre janë në Central Buildings, 51a O'Connell Street, Limerick. Ju mund t'i kontaktoni duke telefonuar në numrin: **061 310 328**. Për më shumë informacion, vizito: **www.dorasluimni.org**

Crosscare

jep informacion dhe këshilla për strehimin, mirëqenien sociale, arsimin, ribashkimin familjar dhe çështje të tjera të imigracionit. Ata kanë një shërbim në dispozicion për refugjatët në 1 Cathedral Street, Dublin 1. Ju mund t'i kontaktoni duke telefonuar në numrin: **01 873 2844** ose duke dërguar email në adresën: **crs@crosscare.ie**. Për më shumë informacion, vizito: **www.crosscare.ie/refugee-service**

JRS (Shërbimi për Refugjatët Jesuit)

Irlanda siguron ndihmë për personat që kërkojnë informacione të drejtpërdrejta për azil, kurse të gjuhës dhe mbështetje psikosociale. Zyrat e tyre janë në 54-72 Gardiner Street Upper Dublin 1 D01 TX23. Ju mund t'i kontaktoni duke telefonuar në numrin: **01 814 8644** ose duke plotësuar një formular kontakti në faqen e tyre të internetit: **www.jrs.ie/index.php/contact**. Ju mund të lexoni më shumë rreth JRS Ireland në: **www.jrs.ie**

SPIRASI

ndihmon të mbijetuarit e torturës dhe ofron kurse falas në një numër fushash, duke përfshirë gjuhën angleze, aftësitë kompjuterike dhe artin. Zyrat e tyre janë në 213 North Circular Road, Phibsborough dhe mund të kontaktohen në numrin: **01 838 9664**. Për më shumë informacion, vizito: **www.spirasi.ie**

Ky udhëzues është hartuar nga
zyra e Komisionerit të Lartë të
Kombeve të Bashkuara për
Refugjatët (UNHCR) në Irlandë.

UNHCR punon me qeveritë, OJQ-të dhe partnerët e tjerë
për të mbrojtur refugjatët, azil-kërkuesit dhe personat pa
shtetësi. Ju mund të vizitoni faqen tonë të internetit në:

www.unhcr.org/en-ie

Nëse dëshironi të kontaktoni zyrën tonë, na shkruani një
email në adresën **ireduprt@unhcr.org**, ose na telefononi në
numrin **01 631 4510**.

Zyrat e tyre janë në 102 Pembroke Road,
Ballsbridge, Dublin 4.



102 Pembroke Road,
Ballsbridge, Dublin 4, Irlandë

Tel. +353 (0)1 631 4510

ireduprt@unhcr.org

www.unhcr.org